VENDIM
Nr. 142, datë 6.9.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS SË PËRDORIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR.

Në mbështetje të neneve 16; 32 dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 "Për gazin natyror", si dhe nenit 26 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe të Çmimeve mbi miratimin e "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror",

konstatoi:

- ERE është organi kompetent që miraton metodologjinë dhe përcakton tarifat për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifat e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifat për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifat e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik.
- Kjo metodologji mbështetet në parashikimet e neneve 16, 32 dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror"

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror".
2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti